



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË RANILLUGUT PËR VITIN 2020

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Vladica Artonovic, Kryetar
Adresa: Ranillug, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Ranillugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ranillugut (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ranillugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Ranillugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KR kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ranillugut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Ranillugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Ranillugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Ranillugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Ranillugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalljet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Çështjet për pasqyrat financiare

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja B1 - Mos paraqitja e pagesave nga palët e treta në Pasqyra Financiare

Gjetja Sipas rregullores MF-nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 9.6 përcakton se të gjitha pagesat nga palët e treta duhet të regjistrohen në SIMFK në harmoni me procedurën përkatëse dhe të prezantohen në pasqyrat financiare.

Komuna nuk kishte regjistruar dhe paraqitur në Pasqyrat Financiare vlerën prej 9,437€, të pranuar si pagesë nga palët e treta e cila ishte bashkëfinancim me komunën për projektin e furnizimit me "Tabela Interaktive, Laptop dhe Projektor për shkollat në Komunën e Ranillugut".

Kjo ka ndodhur pasi ishte bërë një lëshim nga ana e zyrtarëve komunal.

Ndikimi Mos paraqitja e pagesave nga palët e treta të cilat janë bërë për të përkrahur komunën, shpie në paraqitjen e shënimeve të gabuara në PFV.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se paraqitja e pagesave nga palët e treta të bëhet sipas kërkesave të rregullores për raportim financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Ranillugut në 2020 ishin 60,131€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore. Poashtu Komuna e Ranillugut kishte inkasuar edhe të hyra indirekte në vlerë prej 2,789€. Kjo shumë përbëhet nga Gjobat e Policisë në vlerë prej 2,715€ dhe nga Gjobat e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës në vlerë prej 74€.

Çështja B2 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

Gjetja

Sipas nenit 15.2 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme parashihet që veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të gjitha objekteve brenda territorit të komunës.

Komuna në vitin 2020, prej 1,297 pronave të regjistruara kishte arritur të kryej verifikimin e vetëm 84 objekteve apo 6% të pronave të paluajtshme.

Sipas zyrtareve komunal kjo ka ndodhur për shkak se në njësinë e tatimit në pronë është i punësuar vetëm një zyrtar, i cili për shkak të vëllimit të punëve, nuk kishte mundësi të përmbush këtë kërkesë ligjore.

Ndikimi

Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në ngarkesa tatimore joadekuate.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të marrë në konsideratë plotësimin e vendeve të punës në këtë departament, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer verifikimin e objekteve sipas dispozitave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 340,859€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 295,394€. Ato kanë të bëjnë me përkrahje financiare të entiteteve publike dhe jo-publike. Kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 266,339€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Mungesa e planit vjetor për mbështetje financiare për OJQ

Gjetja	<p>Rregullorja e MF - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Neni 6.1 përcakton se “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe të njëjtin ia dërgojnë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës”.</p> <p>As këtë vit Komuna nuk e kishte dërguar në ZKM Planin Vjetor për subvencionimin e OJQ-ve, edhe pse ka qenë rekomandim edhe vitin e kaluar.</p> <p>Zyrtarët komunal nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim për mos përmbushjen e kësaj kërkesë.</p>
Ndikimi	Mungesa e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, paraqet mungesë të informatave së cilat fusha do përkrahen nga komuna, si dhe qëllimet se për çfarë janë të parapara këto mjete.
Rekomandimi B3	Kryetari duhet të sigurojë se plani vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, do të përgatitet dhe dërgohet me kohë në ZKM, duke përcaktuar qartë fondet e parapara për subvencione dhe fushat të cilat do të mbështeten nga komuna.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 8,801,691€, pasurive jokapitale është 74,707€, si dhe e stoqeve zero. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 1,099,326€, si dhe kemi bërë teste të pajtueshmërisë.

Çështja C1 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 19, ndër të tjera thotë përgjegjësitë e komisionit për inventarizim janë: inventarizimi i pasurisë që është në pronësi dhe kontroll të organizatës, e cila duhet të verifikohet fizikisht dhe të krahasohet me regjistrat e pasurisë jo-financiare.

Zyrtarët Komunal kishin kryer inventarizimin e pasurisë, mirëpo raporti i inventarizimit nuk ishte i plotë meqenëse përmbante vetëm pasuritë me vlerë nën 1,000 € dhe jo pasuritë kapitale të Komunës. Për këtë nuk kemi marrë ndonjë sqarim nga zyrtarët përgjegjës.

Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë neni 6, pika 3 pasuria nën 1,000€, duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Komuna nuk përdorë programin E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë nën 1,000€, komuna për rexhistrimin e pasurisë nën 1,000 përdor aplikacionin Excel. Zyrtarët komunal pohojnë se ka probleme teknike me funksionalizimin e këtij Softueri.

Sipas nenit 4 të rregullores 02/2013, Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë të komunës. Nuk kemi marrë ndonjë sqarim nga zyrtarët komunal përse ende nuk janë aprovuar këto rregulla dhe procedura.

Ndikimi

Mos përfshirja e të gjitha pasurive në raportin e inventarizimit e që janë pronë e Komunës dhe mos përdorimi i programit E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë pasqyrojnë dobësi në menaxhimin e pasurive dhe rrjedhimisht ndikon në mos prezantim të drejtë të vlerës së pasurisë në PFV. Mos aprovimi i rregullave dhe procedurave të brendshme mund të ndikojë që pasuria të keqpërdoret apo të humbet.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë se në raportin e inventarizimit të pasurisë të përfshihet e gjithë pasuria e cila është pronë e Komunës. Gjithashtu duhet të sigurojë funksionalizimin e sistemit E-pasuria siç e kërkojnë rregulloret në fuqi si dhe të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 415,025€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 209,614€, taksë për ushtrimin e veprimtarisë afariste 54,063€, shitja e shërbimeve 135,866€ dhe shfrytëzimi i hapësirave publike 15,482€.

Çështja B4 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenin 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtyllë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna për të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 209,614€ të cilat krahasuar me vitin e kaluar ishin rritur për 14,312€, nuk kishte ndërmarr ndonjë aktivitet për mbledhjen e tyre siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë.

Sipas nenit 56 të rregullores për taksa tarifa dhe gjopa komunale, ndër të tjera si mekanizëm për mbledhje të borxhit parashihen edhe veprimet si: borxhliut i dërgohet urdhër për pagesë të taksës me vërejtjen për përmbarim, kamata do të fillojë të llogaritet nga data e vendosur në vendim për arkëtimin e borxhit; ndërprerja e veprimtarisë afariste (mbyllja për tri ditë); malli do të regjistrohet dhe do të merret (konfiskimi i pasurisë) dhe shitja e pasurisë përmes ankandit. Të arkëtueshmet nga shitja e shërbimeve (mbledhja e mbeturinave) në fundi të vitit 2020 ishin 135,866€, që i bie nga viti i kaluar janë rritur për 4,717€. Të arkëtueshmet nga shfrytëzimi i hapësirave publike ishin rritur për 3,717€ krahasuar me vitin 2019.

Komuna nuk kishte marrë ndonjë aktivitet për mbledhjen e këtyre llogarive të arkëtueshme siç parashihet me ligj apo rregullore.

Ndikimi

Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuara me ligj ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, dhe inkurajon debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre. Rrjedhimisht, kjo redukton kapacitetin e komunës për të financuar nevojat e saj nga burimet vetjake.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të analizojë në mënyrë të detajuar gjendjen e borxheve që debitorët i detyrohen komunës, të propozoj masa më efektive si dhe të aplikoj të gjithë mekanizmat në dispozicion për mbledhjen e këtyre borxheve, duke mos përgjashtuar edhe masat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna ka të themeluar Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), por ajo gjatë vitit 2020 nuk ishte funksionale.

Çështja A1 - Mos funksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Komunë

Gjetja Sipas rregullores QRK.nr01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 4, parasheh se Komuna ka katër mënyra për kryerjen e auditimeve të brendshme: themelimin e njesisë së auditimit në kuadër të Komunës, njësi të përbashkët me subjekte të tjera të sektorit publik, marrëveshje me ndonjë subjekt publik për kryerjen e shërbimeve të auditimit apo edhe kontraktimit të një kompanie profesionale.

Komuna gjatë vitit 2020 nuk kishte kryer asnjë auditim të brendshëm, pasi që auditori i brendshëm ishte në pushim pa pagesë dhe si rezultat Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ishte funksionale.

Auditori i brendshëm/Drejtori i auditimit ka marrë pushim pa pagesë për një periudhë të caktuar kohore pasi që ka dalë përkohësisht të punoj jashtë institucioneve publike.

Ndikimi Mungesa e funksionimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm nënkupton që Komuna nuk ka një mekanizëm të pavarur dhe objektiv i cili shërben si këshillëdhënës në ofrimin e sigurisë së arsyeshme mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve operative.

Rekomandimi A1 Kryetari i Komunës të funksionalizojë Njësinë e Auditimit të Brendshëm, ose të shqyrtohen mundësitë tjera të sigurimit të shërbimeve të auditimit, siç përcaktohen me Rregulloren e mësipërme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Mungesa e komitetit të auditimit

Gjetja Udhëzimi administrativ MF-nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 4.1 themelimi i komitetit të auditimit: Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Komuna ende nuk kishte themeluar Komitetin e Auditimit, edhe pse lidhur me këtë ishte dhënë rekomandim edhe vitin e kaluar.

Për mos adresimin e këtij rekomandimi, nuk na është dhënë ndonjë shpjegim i vlefshëm nga zyrtarët komunal.

Ndikimi Mungesa e komitetit të auditimit mund të ndikojë në pavarësinë e Njesisë së Auditimit nga ndërhyrjet e menaxherëve, si dhe mos-adresimin e duhur të rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të themelojë dhe ta bëjë funksional komitetin e auditimit, që t'i rishikojë rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,918,848	2,386,425	1,961,837	1,682,939	1,838,350
Grante Qeveritare - Buxheti	1,790,284	2,020,445	1,879,797	1,629,933	1,742,574
Financimi përmes huamarrjes	0	16,380	16,380	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	218,613	55,083	44,227	76,266
Të hyrat vetanake	128,564	128,564	10,576	8,779	5,415
Donacionet e jashtme	0	2,423	0	0	14,095

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 467,577€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit të Ligjit të Buxhetit, Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak si dhe donacioneve.

Në vitin 2020 komuna ka shpenzuar 82% të buxhetit përfundimtar ose 1,961,837€, njëjtë si në vitin 2019 sa i përket përqindjës së shpenzimit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,918,848	2,386,425	1,961,837	1,682,939	1,838,350
Pagat dhe mëditjet	1,100,966	1,111,363	1,111,363	1,086,777	1,039,960
Mallrat dhe shërbimet	215,000	286,071	217,205	167,009	105,066
Komunalitë	40,000	80,628	39,581	35,142	30,618
Subvencionet dhe transferet	45,000	340,859	295,394	34,938	36,191
Investimet Kapitale	318,848	567,505	298,294	359,073	626,515
Rezervat	199,034	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti përfundimtar për kategorinë e Pagave dhe mëditjeve ishte rritur për 10,397€. Kjo rritje vjen nga kategoria e Rezervës e transferuar në kategorinë Pagave dhe Mëditjeve në vlerë prej 16,695€, si dhe zvogëlim nga Vendimit i Qeverisë së datës 21/12/2020 nr. 08/50 në vlerë prej 6,298€.

Buxheti përfundimtar për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve ishte rritur për 71,071€ krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimi i Kuvendit Komunal për bartjen e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti paraprak në vlerë prej 48,836€, vlera prej 20,000€ ishte rritje nga Vendimi i Kuvendit Komunal për bartjen e mjeteve nga kategoria e Rezervës në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve si dhe 2,235€ ishin nga bartja e Donacioneve nga viti i kaluar.


Buxheti përfundimtar për kategorinë e Shërbimeve Komunale ishte rritur për 40,628€ krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimi i Kuvendit Komunal për bartjen e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti paraprak në vlerë prej 31,728€, rritja prej 10,000€ nga Vendimi i Kuvendit Komunal për bartjen e mjeteve nga kategoria e Rezervës në kategorinë e Shërbimeve Komunale në vlerë prej 10,000€, si dhe Vendimit i Qeverisë së datës 21/12/2020 nr. 08/50 për zvogëlimin e buxhetit në këtë kategori në vlerë prej 1,100€.

Buxheti përfundimtar për kategorinë e Subvencioneve ishte rritur për 295,859€ krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimi i Kuvendit Komunal për bartjen e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti paraprak në vlerë prej 20,000€, rritja prej 10,000€ nga Vendimi i Kuvendit Komunal për bartjen e mjeteve nga kategoria e Rezervës në kategorinë e Subvencioneve në vlerë prej 10,000€, si dhe rritja për 265,859€ nga vendim 01/23 i datës 13/08/2020 të Ministrisë së Pushtetit Lokal.

Buxheti përfundimtar për Investime Kapitale krahasuar me atë fillestar ishte rritur për 248,657€. Kjo rritje është bërë bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal për bartjen e të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vlerë prej 118,049€, rritja nga kategoria e Rezervës e transferuar në kategorinë Investimeve Kapitale me Vendim të Kuvendit Komunal në vlerë prej 142,339€, rritja 189€ është bartje nga donacionet e pashpenzuara nga vitet e kaluara si dhe zvogëlimi i bazuar në Vendimin e Qeverisë së datës 21/12/2020 nr. 08/50 në vlerë prej 11,920€.

Sa i përket mjeteve të shpenzuara për menaxhimin e situatës së Pandemisë Covid-19 ato ishin në vlerë prej 342,512€.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020




Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	128,564	128,564	60,131	88,904	83,338
Të hyrat tatimore	41,954	41,954	27,837	26,085	23,809
Të hyrat jo tatimore	86,610	86,610	32,294	62,819	59,529

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Ranillugut ka rezultuar në 10 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, kater (4) rekomandime janë zbatuar; një (1) ishin në proces dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak





Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se paraqitja e pagesave nga palët e jashtme të bëhet sipas kërkesave të rregullores për raportim financiar.	Gjendja është e njëjtë.	Nuk është adresuar
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të marrë në konsideratë plotësimin e vendeve të punës në këtë departament, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer verifikimin e objekteve sipas dispozitave ligjore.	Rekomandim i pazbatuar.	Nuk është adresuar

3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se gjatë punësimit të punonjësve të rinj, të zbatohen të gjitha kërkesat e Udhëzimit Administrativ në fuqi.	Konsiderohët i zbatuar pasi këtë vit nuk kemi bërë testime të pajtueshmerisë për rekrutim.	Nuk është i aplikueshëm më
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se për çdo kontratë të nënshkruar të emërojë edhe menaxherin e kontratës.	Komuna gjatë vitit 2020 ka emëruar Menaxher të kontratave.	I zbatuar
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet plani vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, në bazë të fushave dhe qëllimeve të caktuara.	Shih çështjen	Nuk është adresuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë se me rastin e kontraktimit të punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në të kundërtën procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.		I zbatuar
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se inventarizimi i pasurisë të kryhet sipas rregulloreve në fuqi, ku pjesë e raportit përfundimtar të jetë edhe lista e pasurive të verifikuara dhe të krahasuara me regjistrin e pasurive. Gjithashtu duhet të sigurojë se pasuria nën 1,000€ të regjistrohet në sistemin e-pasuria siç e kërkojnë rregulloret në fuqi si dhe të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth pasurisë.	Nuk është adresuar rekomandimi i vitit të kaluar në tërësi.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, shitja e shërbimeve, nga taksat e biznesit dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Gjendja është e njëjtë edhe këtë vit.	Nuk është adresuar
9.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj që faturat e pranuar të paguhen brenda afatit ligjor si dhe të siguroj që kthimi i faturave të parregullta bëhet përmes protokollit.		I zbatuar
10.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të themeloj dhe ta bëjë funksional komitetin e auditimit, që t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.	Komuna nuk ka marrë veprime për të adresuar këtë rekomandim, poashtu ajo gjatë vitit 2020 nuk ka pasur as edhe Auditor të brendshëm.	Nuk është adresuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se paraqitja e pagesave nga palët e treta të bëhet sipas kërkesave të rregullores për raportim financiar.
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të marrë në konsideratë plotësimin e vendeve të punës në këtë departament, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer verifikimin e objekteve sipas dispozitave ligjore.
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se plani vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, do të përgatitet dhe dërgohet me kohë në ZKM, duke përcaktuar qartë fondet e parapara për subvencione dhe fushat të cilat do të mbështeten nga komuna.
4.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se në raportin e inventarizimi të pasurisë të përfshihet e gjithë pasuria e cila është pronë e Komunës. Gjithashtu duhet të sigurojë funksionalizimin e sistemit E-pasuria siç e kërkojnë rregulloret në fuqi si dhe të hartojë rregulla dhe procedura të brendshme rreth pasurisë.
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të analizojë në mënyrë të detajuar gjendjen e borxheve që debitorët i detyrohen komunës, të propozoj masa më efektive si dhe të aplikoj të gjithë mekanizmat në dispozicion për mbledhjen e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat ligjore.
6.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari i Komunës të funksionalizojë Njësinë e Auditimit të Brendshëm, ose të shqyrtohen mundësitë tjera të sigurimit të shërbimeve të auditimit, siç përcaktohen me Rregulloren e Mësipërme.
7.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të themelojë dhe ta bëjë funksional komitetin e auditimit, që t'i rishikojë rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Zukë Zuka, Udhëheqës i Auditimit



Pleurat Isufi, Udhëheqës i ekipit



Milos Petrovic, Anëtar i ekipit




Gazmend Namani, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi


REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DIFERENCIALI I ZYRËS REGJISTRIMI: 15.06.2021 DITËRREGO: 15.06.2021			
Mënyra Org. Org. Jeftin. Org. Un.*	Shifërkodifik. Klasifik. Kod Klasifik. Code	Nr. Prot. Str. Prot. Prot. No.	Nr. faqëve Str. Stranica No. Pages
04	47	867	2

01-235/ 2021
14.06.2021



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit


Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Ranillugut, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe (kjo pikë përshtatet nga entiteti)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfaqësojë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Vladica Arifović
Kryetar i Komunes së Ranillugut

Data: 14.qershor.2021, Ranillug.



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA BOSNIJE I HERCEGOVINE ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
1001			
Adresa / Adresa	Adresa / Adresa	Adresa / Adresa	Adresa / Adresa
04	47	067	2

01-230/ 2021
14.06.2021



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Opština Ranilug
Komuna e Ranilugut
Municipality of Ranilug



POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2020 godinu kao i za sprovođenje preporuka

Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:

Poštovani,

Preko ovog pisma, potvrđujem da:

- sam primio nacrt Izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine Ranilug za godinu završno sa 31 decembrom 2020 (u daljem tekstu "Izveštaj");
- slažem se / ne slažem se / delimično se slažem sa nalazima i preporukama i nemam neki komentar u vezi sa sadržajem izveštaja (ovu tačku prilagodava entitet); i da ću
- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.

g. Vladica Arifmović

Gradonačelnik Opštine Ranilug

Datum: 14.06.2021, Ranilug.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.